

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 710

INFORMACIONET KRAHASUESE – SHIFRAT KORRESPONDUESE DHE PASQYRAT FINANCIARE KRAHASUESE

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Natyra e Informacionit Krahasues	2-3
Hyrja në fuqi	4
Objektivat	5
Përkufizimet	6
Kërkesat	
Procedurat e Auditimit	7-9
Raportimi i Auditimit	10-19
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Procedurat e Auditimit	A1
Raportimi i Auditimit	A2-A13
Shtojcë: Ilustrime të Raporteve të Audituesve	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 710, “Informacionet Krahasuese – Shifrat Korresponduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese”, duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA), trajton përgjegjësitë që ka audituesi lidhur me informacionin krahasues në një auditim të pasqyrave financiare. Kur pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme kanë qenë audituar nga një auditues paraardhës ose kur ato nuk kanë qenë audituar, për tepricat e çeljes do të zbatohen edhe kërkesat dhe udhëzimet që jepen në SNA 510¹.

Natyra e Informacionit Krahasues

2. Natyra e informacionit krahasues që është paraqitur në pasqyrat financiare të një entiteti varet nga kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar. Ekzistojnë dy metoda të ndryshme, që përdoren gjerësisht, të cilat trajtojnë përgjegjësitë e raportimit të audituesit në lidhje me këto informacione krahasuese: shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare krahasuese. Metoda që duhet të përdoret, shpesh specifikohet nga ligji ose rregulli, por gjithashtu, ajo mund të specifikohet edhe në kushtet e angazhimit.
3. Diferencat thelbësore të raportimit të auditimit ndërmjet dy metodave janë:
 - (a) Për shifrat korresponduese, opinioni i audituesit mbi pasqyrat financiare i referohet vetëm periudhës aktuale, ndërsa
 - (b) Për pasqyrat financiare krahasuese, opinioni i audituesit i referohet secilës periudhë për të cilën janë paraqitur pasqyrat financiare.

Ky SNA trajton veçmas kërkesat e raportimit të audituesit për çdo metodë.

Hyrja në fuqi

4. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivat

5. Objektivat e audituesit janë:
 - (a) Të sigurojë evidencën e nevojshme për faktin nëse informacion krahasues i përfshirë në pasqyrat financiare, është paraqitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për informacion krahasues që janë dhënë në kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, dhe

¹ SNA 510, *Angazhimet Fillestare të Auditimit – Tepricat e Çeljes*.

- (b) Për të raportuar në përputhje me përgjegjësitë që ka audituesi për të raportuar.

Përkufizimet

6. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:
- (a) Informacioni krahasues - shumat dhe informacionet shpjeguese të përfshira në pasqyrat financiare në lidhje me një ose më shumë periudha të mëparshme në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
 - (b) Shifrat Korresponduese – Informacioni krahasues, ku shumat dhe informacionet e tjera shpjeguese të periudhës së mëparshme janë përfshirë si një pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të periudhës aktuale, dhe prashikohet të lexohen vetëm të lidhura me shumat dhe informacionet e tjera shpjeguese të dhëna të lidhura me periudhën aktuale (të referuara si “shifra të periudhës aktuale”). Niveli i detajeve që paraqiten në shumat korresponduese dhe në informacionet shpjeguese të dhëna, diktohet kryesisht nga përkatësia e tij për shifrat e periudhës aktuale.
 - (c) Pasqyrat financiare krahasuese - Informacioni krahasues, ku shumat dhe informacionet e tjera shpjeguese të dhëna për periudhën e mëparshme janë përfshirë për krahasimin me pasqyrat financiare të periudhës aktuale, por, në qoftë se janë të audituara, ato janë përmendur në opinionin e audituesit. Niveli i informacionit të përfshirë në këto pasqyra financiare krahasuese është i krahasueshëm me atë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale.

Për qëllime të këtij SNA-je, referencat për “periudhën e mëparshme” duhet të lexohen si “periudhat e mëparshme” kur informacioni krahasues përfshin shumat dhe informacionet shpjeguese të dhëna për më shumë se një periudhë.

Kërkesat

Procedurat e Auditimit

7. Audituesi do të përcaktojë nëse pasqyrat financiare përfshijnë informacionin krahasues që kërkohet sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar dhe nëse ky informacion është klasifikuar në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim, audituesi do të vlerësojë nëse:
- (a) Informacioni krahasues rakordon me shumat dhe informacionet e tjera shpjeguese të paraqitura në periudhën e mëparshme, ose, kur duhet, ai është riparaqitur; dhe
 - (b) Politikat kontabël që reflektohen në informacionin krahasues janë në koherencë me ato që janë zbatuar në periudhën aktuale ose, kur ka patur ndryshime në politikat kontabël, nëse këto ndryshime janë trajtuar nga pikëpamja kontabël në mënyrën e duhur dhe janë paraqitur e shpjeguar mjaftueshëm.

8. Në qoftë se gjatë kryerjes së auditimit të periudhës aktuale, audituesi vihet në dijeni të një anomalie materiale të mundshme në informacionin krahasues, ai duhet të kryejë ato procedura auditimi shtesë, të cilat janë të nevojshme për rrethanat për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit për të përcaktuar nëse ekziston një anomali materiale. Në qoftë se audituesi i ka audituar pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme, ai duhet të zbatojë edhe kërkesat përkatëse të SNA 560². Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë ndryshuar, audituesi duhet të provojë që informacioni krahasues rakordon me pasqyrat financiare të ndryshuara.
9. Siç kërkohet nga SNA 580³, audituesi do të kërkojë deklarime me shkrim për të gjitha periudhat e referuara në opinionin e audituesit. Audituesi, duhet gjithashtu, të marrë një deklaram të veçantë me shkrim në lidhje me ndonjë riparaqitje të bërë për të korrigjuar një anomali materiale në pasqyrat financiare në periudhën e mëparshme, e cila ka ndikim në informacionin krahasues. (Ref: Para. A1)

Raportimi i Auditimit

Shifrat Korresponduese

10. Kur janë paraqitur shifrat korresponduese, opinionin e audituesit nuk do t'ju referohet shifrave korresponduese, përveçse në rrethanat e përshkruara në paragrafët 11, 12, dhe 14. (Ref: Para. A2)
11. Nëse në raportin e audituesit mbi periudhën e mëparshme, të lëshuar më parë, është përfshirë një opinion me rezervë, një refuzim për të dhënë opinion, ose një opinion kundër dhe çështja që ka çuar në modifikim është e pazgjidhur, audituesi duhet të modifikojë opinionin e tij mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Në paragrafin e Bazës për Modifikim, në raportin e audituesit, audituesi:
 - (a) Për të përshkruar çështjen që çon në modifikim, do t'i referohet si shifrave të periudhës aktuale ashtu edhe shifrave korresponduese, kur efektet apo efektet e mundshme të çështjes, mbi shifrat e periudhës aktuale janë materiale, ose
 - (b) Në raste të tjera, do të shpjegojë se opinionin e auditimit është modifikuar për shkak të efekteve ose efekteve të mundshme të çështjes së pazgjidhur në krahasueshmërinë e shifrave të periudhës aktuale dhe shifrave korresponduese. (Ref: Para. A3-A5)
12. Nëse audituesi merr evidencë auditimi që tregon se ekziston një gabim material në pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme për të cilën ka qënë lëshuar një opinion pa rezervë, dhe shifrat korresponduese nuk janë riparaqitur në mënyrën e duhur, ose nuk janë dhënë informacionet shpjeguese që kërkohen, audituesi do të shprehë një opinion me rezervë ose një opinion kundër në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale, të modifikuar në lidhje me shifrat korresponduese të përfshira në to. (Ref: Para A6)

² SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*, paragrafët 14–17.

³ SNA 580, *Deklarimet me Shkrim*, paragrafi 14.

INFORMACIONET KRAHASUESE – SHIFRAT KORRESPONDUESE
DHE PASQYRAT FINANCIARE KRAHASUESE

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme janë Audituar nga një Auditues Paraardhës (i mëparshëm)

13. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga një auditues paraardhës dhe audituesi nuk ndalohet nga ligji ose rregulli që t'i referohet raportit të audituesit të mëparshëm për shifrat korresponduese, dhe ai vendos të veprojë në këtë mënyrë, audituesi në një paragraf për Çështje të Tjera në raportin e audituesit do të tregojë:
- (a) Që pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse kanë qënë audituar nga audituesi i mëparshëm;
 - (b) Llojin e opinionit të shprehur nga audituesi i mëparshëm dhe, në qoftë se opinionin ka qënë modifikuar, arsyet e këtij modifikimi; dhe
 - (c) Datën e këtij raporti. (Ref: Para A7)

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme nuk Kanë Qënë Audituar

14. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme nuk kanë qënë audituar, audituesi, në raportin e audituesit, në një paragraf për Çështje të Tjera, do të tregojë se shifrat korresponduese nuk janë audituar. Megjithatë, kjo deklaratë nuk e çliron audituesin nga kërkesa për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit për faktin që tepricat e celjes nuk përmbajnë anomali që ndikojnë materialisht pasqyrat financiare të periudhës aktuale⁴. (Ref: Para. A8)

Pasqyrat Financiare Krahasuese

15. Kur janë paraqitur pasqyrat financiare krahasuese, opinionin e audituesit do të referojë çdo periudhë për të cilën janë paraqitur këto pasqyra dhe për të cilat është dhënë një opinion auditimi. (Ref: Para. A9-A10)
16. Kur në lidhje me auditimin e periudhës aktuale raportohet mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme, në qoftë se opinionin e audituesit mbi këto pasqyra financiare të periudhave të mëparshme ndryshon nga opinionin e shprehur prej audituesit të mëparshëm, audituesi duhet të shpjegojë arsyet thelbësore për diferencat në opinion në një paragraf për Çështje të Tjera, në pajtim me SNA 706 (i rishikuar).⁵ (Ref: Para. A11)

⁴ SNA 510, paragrafi 6.

⁵ SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi 8.

INFORMACIONET KRAHASUESE – SHIFRAT KORRESPONDUESE
DHE PASQYRAT FINANCIARE KRAHASUESE

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme janë Audituar nga një Auditues Paraardhës

17. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga një auditues paraardhës, përveç shprehjes së një opinionit mbi pasqyrat financiare të periudhës së aktuale, audituesi do të deklarojë në një paragraf për Çështje të Tjera:

- (a) që pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme kanë qënë audituar nga një auditues i mëparshëm;
- (b) llojin e opinionit të shprehur nga ana e audituesit të mëparshëm dhe, nëse opinionit është i modifikuar, arsyet për këtë modifikim, dhe
- (c) datën e këtij raporti,

përveç nëse raporti i audituesit paraardhës për pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme është rilëshuar bashkë me pasqyrat financiare.

18. Nëse audituesi arrin në përfundimin se ekziston një anomali materiale, e cila ka ndikim në pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme për të cilat audituesi paraardhës ka raportuar pa modifikime, audituesi do të komunikojë për anomalinë me nivelin e duhur të drejtimit dhe, me përjashtim të rasteve kur të gjithë personat e ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit⁶, me personat e ngarkuar me qeverisjen, dhe të kërkojë që të informohet audituesi paraardhës. Në qoftë se pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë ndryshuar dhe audituesi paraardhës pranon të lëshojë një raport audituesi të ri mbi këto pasqyra financiare të periudhës së mëparshme të ndryshuara, audituesi do të raportojë vetëm për periudhën aktuale. (Ref: Para. A12)

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme Nuk Janë Audituar

19. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme nuk janë audituar, audituesi duhet të deklarojë në një paragraf për çështje të tjera, që pasqyrat financiare krahasuese nuk janë audituar. Megjithatë, kjo deklaratë nuk do ta çlirojë audituesin nga kërkesa për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit që tregon se tepricat e çeljes nuk përmbajnë anomali që ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.⁷ (Ref: Para. A13)

⁶ SNA 260, *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 13.

⁷ SNA 510, paragrafi 6.

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Procedurat e Auditimit

Deklarimet me shkrim (Ref: Para. 9)

A1. Në rastin e pasqyrave financiare krahasuese, deklaratimet me shkrim kërkohet të bëhen për të gjitha periudhat që referohen në raportin e audituesit, për shkak se drejtimi duhet të riafirmojë se deklaratimet me shkrim që ai ka bërë më parë në lidhje me periudhën e mëparshme mbeten të përshtatshme. Në rastin e shifrave korresponduese, deklaratimet me shkrim janë kërkuar për pasqyrat financiare të periudhës aktuale vetëm për shkak se opinioni i audituesit është për këto pasqyra financiare, të cilat përfshijnë shifrat korresponduese. Megjithatë, audituesi kërkon një deklaram të veçantë me shkrim në lidhje me ndonjë riparaqitje të bërë për të korrigjuar një anomalie materiale në pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme, e cila ka ndikim në informacionin krahasues.

Raportimi i Auditimit

Shifrat Korresponduese

Asnjë Referencë nuk Është Bërë në Opinionin e Audituesit (Ref: Para. 10)

A2. Opinioni i audituesit nuk ka të bëjë me shifrat korresponduese për shkak se opinioni i audituesit është mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale të marra në tërësi, duke përfshirë shifrat korresponduese.

Modifikimi në Raportin e Audituesit për Periudhën e Mëparshme Është i Pazgjdhur (Ref: Para. 11)

A3. Kur raporti i audituesit për periudhën e mëparshme, i lëshuar më parë, ka përfshirë një opinion me rezervë, një refuzim për të dhënë opinion, ose një opinion kundër dhe çështja që ka çuar në modifikimin e opinionit është zgjidhur ose trajtuar në mënyrën e duhur nga pikëpamja kontabël apo shpjeguar në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, opinioni i audituesit për periudhën aktuale nuk duhet të referohet modifikimit të mëparshëm.

A4. Kur opinioni i audituesit për periudhën e mëparshme, i shprehur më parë, ka qënë modifikuar, çështja e pazgjdhur që ka çuar në modifikim mund të mos jetë e përshtatshme për shifrat e periudhës aktuale. Megjithatë, për pasqyrat financiare të periudhës aktuale, mund të kërkohet të jepet një opinion me rezervë, një refuzim për dhënie të opinionit, ose një opinion kundër (sipas rastit) për shkak të efekteve ose efekteve të mundshme të çështjes së pazgjdhur në krahasueshmërinë e shifrave aktuale dhe atyre korresponduese

A5. Shembuj ilustrues të raportit të audituesit, kur në raportin e audituesit për periudhat e mëparshme përfshihet një opinion i modifikuar dhe çështja që ka çuar në modifikim ka mbetur e pazgjidhur, janë dhënë në Ilustrimet 1 dhe 2 të Shtojcës.

Anomali në pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme (Ref: Para. 12)

A6. Kur pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme, të cilat janë keqparaqitur, nuk kanë qenë modifikuar dhe raporti i një audituesit nuk ka qenë rilëshuar, por shifrat korresponduese, janë riparaqitur në mënyrën e duhur ose në pasqyrat financiare të periudhës aktuale janë dhënë shënimet e duhura shpjeguese, raporti i audituesit mund të përfshijë një paragraf që thekson një Çështje për të përshkruar rrethanat dhe për t'ju referuar informacioneve shpjeguese, kur kjo është e mundur, të cilat përshkruajnë plotësisht çështjen që mund të gjendet në pasqyrat financiare. (shiko SNA 706 (i rishikuar))

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme janë Audituar nga një Auditues i Mëparshëm (Ref: Para. 13)

A7. Një shembull ilustrues i raportit të audituesit, kur pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme nuk janë audituar nga një auditues paraardhës dhe audituesi nuk ndalohej nga ligji ose rregulli t'i referohet raportit të audituesit paraardhës mbi shifrat korresponduese, është dhënë në Ilustrimin 3 të shtojcës.

Pasqyrat financiare të Periudhës së Mëparshme nuk janë Audituar (Ref: Para. 14)

A8. Kur audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me tepricat e çeljes, sipas SNA 705 (i rishikuar)⁸, audituesi kërkohet të shprehë sipas rastit, një opinion me rezervë ose një opinion kundër mbi pasqyrat financiare në pajtim me SNA 705 (i rishikuar). Nëse audituesi ka hasur në një vështirësi të madhe në sigurimin e evidencës së nevojshme të auditimit që tregon se tepricat e çeljes nuk kanë anomali që ndikon në mënyrë materiale në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, audituesi mund ta përcaktojë këtë çështje si një çështje kryesore e auditimit në pajtim me SNA 701 (i rishikuar).⁹

Pasqyrat Financiare Krahasuese

Referencë në Opinionin e Audituesit (Ref: Para. 15)

A9. Për shkak se raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare krahasuese zbatohet për pasqyrat financiare për secilën nga periudhat e paraqitura, audituesi mund të shprehë një opinion me rezervë, një opinion kundër, ose një refuzim për dhënie opinionin, apo të përfshijë një paragraf që thekson një çështje në lidhje me një ose më shumë periudha, ndërsa shpreh një opinion auditimi të ndryshëm mbi pasqyrat financiare të periudhës tjetër.

⁸ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

⁹ SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

INFORMACIONET KRAHASUESE – SHIFRAT KORRESPONDUESE
DHE PASQYRAT FINANCIARE KRAHASUESE

A10. Një shembull ilustrues i raportit të audituesit, ku audituesi kërkohet të raportojë mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale dhe pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme në lidhje me auditimin e vitit aktual dhe, periudha e mëparshme përfshin një opinion të modifikuar dhe çështja që ka çuar në modifikim nuk është zgjidhur, jepet në Ilustrimin 4 të Shtojcës.

Opinion i mbi Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme Ndryshon nga Opinion i mëparshëm (Ref: Para. 16)

A11. Kur raportohet mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme në lidhje me auditimin e periudhës aktuale, opinion i shprehur mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme mund të jetë i ndryshëm nga opinion i shprehur më parë, në qoftë se audituesi bëhet i vetëdijshëm për rrethanat apo ngjarjet që ndikojnë materialisht në pasqyrat financiare të një periudhe të mëparshme gjatë auditimit të periudhës aktuale. Në disa juridiksione, audituesi mund të ketë përgjegjësi raportimi shtesë, që synojnë të parandalojnë mbështetjen në të ardhmen mbi raportin e audituesit të lëshuar më parë mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme.

Pasqyrat financiare të Periudhës së Mëparshme janë Audituar nga një Auditues Paraardhës (Ref: Para. 18)

A12. Audituesi paraardhës mund të mos jetë në gjendje ose mund të mos ketë vullnetin të rilëshojë raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme. Një paragraf për çështje të tjera në raportin e audituesit mund të tregojë se audituesi paraardhës ka raportuar mbi pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme përpara ndryshimit. Përveç kësaj, nëse audituesi është angazhuar për të audituar dhe merr evidencën e nevojshme të auditimit për t'u bindur për përshtatshmërinë e ndryshimit, raporti i audituesit mund të përfshijë paragrafin e mëposhtëm:

Si pjesë e auditimit tonë të pasqyrave financiare të vitit 20X2, ne gjithashtu, audituam rregullimet e përshkuara në shënimin X që janë zbatuar për ndryshimin e pasqyrave financiare të vitit 20X1. Sipas opinionit tonë, këto rregullime janë të përshtatshme dhe janë zbatuar siç duhet. Ne nuk ishim të angazhuar për të audituar, rishikuar, ose zbatuar ndonjë procedurë për pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 20X1, përveçse ato që kanë lidhje me korrigjimet, dhe për këtë arsye, ne nuk shprehim një opinion apo ndonjë formë tjetër të sigurisë për pasqyrat financiare të vitit 20X1 të marra në tërësi.

Pasqyrat Financiare të Periudhës së Mëparshme nuk janë Audituar (Ref: Para. 19)

A13. Kur audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me tepricat e çeljes, sipas SNA 705 (i rishikuar), audituesi kërkohet të shprehë, sipas rastit, një opinion me rezervë ose një opinion kundër mbi pasqyrat financiare në pajtim me SNA 705 (i rishikuar). Nëse audituesi ka hasur vështirësi të madhe në sigurimin e evidencës së nevojshme të auditimit që tregon se tepricat e çeljes nuk kanë anomali që ndikon në mënyrë materiale në pasqyrat financiare të periudhës

INFORMACIONET KRAHASUESE – SHIFRAT KORRESPONDUESE
DHE PASQYRAT FINANCIARE KRAHASUESE

aktuale, audituesi mund ta përcaktojë këtë çështje si një çështje kryesore e auditimit në pajtim me SNA 701.

Ilustrime të Raporteve të Audituesve

Ilustrimi 1 - Shifrat Korresponduese

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600)¹⁰
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.¹¹
- Raporti i audituesit për periudhën e mëparshme, siç është lëshuar më parë, ka përfshirë një opinion me rezervë.
- Çështja që ka ndikuar në modifikim nuk është e zgjidhur.
- Efektet ose efektet e mundshme të çështjes në shifrat e periudhës aktuale janë materiale dhe kërkojnë një modifikim në opinionin e audituesit në lidhje me shifrat e periudhës aktuale.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).¹²
- Audituesi nuk kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi nuk ka siguruar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit.

¹⁰ SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e audituesit të entitetit të kontrolluar)*

¹¹ SNA 210, *Rënia Dakort me Kushtet e Angazhimit të Auditimit.*

¹² SNA 570 (i rishikuar), *Vijmësia.*

- **Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.**
- **Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka edhe përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një Adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹³

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Sikurse trajtohet në shënimin X të pasqyrave financiare, në pasqyra nuk është përfshirë asnjë shumë për amortizimin, çka përbën një devijim nga SNRF-të. Një gjë e tillë është rrjedhojë e vendimit të drejtimit në fillim të vitit të mëparshëm financiar, dhe ka bërë që ne të japim rezervë në opinionin tonë mbi pasqyrat financiare të atij viti. Bazuar në metodën lineare të amortizimit dhe normën vjetore prej 5% për ndërtesat e 20% për makineritë e pajisjet, humbja për vitin duhet të ishte shtuar me xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0, AAM-të duhet të ishin zvogëluar me amortizimin e akumuluar prej xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0 dhe humbja e akumuluar duhet të ishte rritur me prej xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto

¹³ Nën-titulli “Raportin mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara¹⁴

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)¹⁵ – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

¹⁴ Në këto raporte auditimi ilustruese, termat drejtimi ose personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zëvendësohen me terma të tjerë që janë të përshtatshëm, në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

¹⁵ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i Një Opinioni dhe Raportimi Mbi Pasqyrat Financiare*

Ilustrimi 2 - Shifrat Korresponduese

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600)
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Raporti i audituesit për periudhën e mëparshme, siç është lëshuar më parë, ka përfshirë një opinion me rezervë.
- Çështja që ka ndikuar në modifikim nuk është e zgjidhur.
- Efektet ose efektet e mundshme në shifrat e periudhës aktuale nuk janë materiale por kërkojnë një modifikim në opinionin e audituesit për shkak të efekteve ose efekteve të mundshme të çështjeve të pazgjidhura në krahasimin e shifrave të periudhës aktuale dhe shifrave korresponduese.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesi nuk kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi nuk ka siguar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka edhe përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një Adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁶

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Për shkak se ne u emëruam auditues të Shoqërisë gjatë vitit 20X0, nuk mundëm të marrim pjesë dhe të vëzhgojmë inventarizimin fizik në fillim të periudhës ose të bindeshim me mjete alternative lidhur me sasitë e inventarit. Meqenëse çeljet e inventarit ndikojnë në përcaktimin e rezultateve të operacioneve, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të kishin qenë të nevojshme të bëheshin axhustime në rezultatet e shfrytëzimit dhe në tepicën e çeljes të fitimeve të mbartura për 20X0. Për rrjedhojë opinionin ynë për pasqyrat financiare të periudhës që përfundon me 31 Dhjetor 2-X0 u modifikua. Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale gjithashtu është modifikuar, për shkak të efekteve të mundshme të kësaj çështje në krahasimin e shifrave të periudhës aktuale dhe shifrave korresponduese.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë

¹⁶Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore.”

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara¹⁷

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

¹⁷ Ose terma të tjera që janë të përshtatshme në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

Ilustrimi 3 - Shifrat Korresponduese

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- **Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).**
- **Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).**
- **Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.**
- **Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion pa rezervë (i pastër).**
- **Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).**
- **Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).**
- **Audituesi nuk kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.**
- **Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.**
- **Pasqyrat përmbajnë shifrat korresponduese dhe pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga audituesi paraardhës.**
- **Audituesi nuk ndalohet nga ligji ose rregullat të referojë audituesin e mëparshëm në raportin e audituesit lidhur me shifrat korresponduese dhe ai ka vendosur të veprojë në këtë mënyrë.**
- **Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.**
- **Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka edhe përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një Adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁸

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet me datën 31 Dhjetor 20X0, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër i cili me datën 31 Mars 20X1 ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]¹⁹

¹⁸ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore.

¹⁹ SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera*.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara²⁰

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

²⁰ Ose terma të tjera që janë të përshtatshme në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

Ilustrimi 4 – Pasqyrat Financiare Krahasuese

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi kërkohet të raportojë si për pasqyrat financiare të periudhës aktuale, ashtu edhe për pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme.
- Raporti i audituesit për periudhën e mëparshme ka përfshirë një opinion me rezervë.
- Çështja që ka çuar në opinion me rezervë ka mbetur e pazgjidhur.
- Efektet ose efektet e mundshme të çështjes në shifrat e periudhës aktuale janë materiale si për pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme ashtu edhe të asaj aktuale dhe kërkojnë një modifikim në opinionin e audituesit.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesi nuk kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi nuk ka siguruar ndonjë informacion tjetër para datës së raportit të audituesit.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka edhe përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një Adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare²¹

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Sikurse trajtohet në shënimin X të pasqyrave financiare, në pasqyra nuk është përfshirë asnjë shumë për amortizimin, çka përbën një devijim nga SNRF-të. Një gjë e tillë është rrjedhojë e vendimit të drejtimit në fillim të vitit të mëparshëm financiar, dhe ka bërë që ne të japim rezervë në opinionin tonë mbi pasqyrat financiare të atij viti. Bazuar në metodën lineare të amortizimit dhe normën vjetore prej 5% për ndërtesat e 20% për makineritë e pajisjet, humbja për vitin duhet të ishte shtuar me xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0, AAM-të duhet të ishin zvogëluar me amortizimin e akumuluar prej xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0 dhe humbja e akumuluar duhet të ishte rritur me prej xxx në 20X1 dhe xxx në 20X0.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAtë). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

²¹ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare²²

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

²² Ose terma të tjera që janë të përshtatshme në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar
SNA 710